

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve

PROGRAMI
I KURSIT TË UNIFIKUAR

PUNIME
PLLAKASHTRIMI

Kodi: PK-B-2-18

Miratoi:

MINISTRI

.....

Tiranë 2018

PROGRAMI I KURSIT TË UNIFIKUAR

“PUNIME PLLAKASHTRIMI”

(PK-B-2-18)

I. Profili Profesional i pllakashtruesit

a) Karakteristikat e pllakashtruesit

Pllakashtruesi është i aftë të kryejë punime dhe të realizojë *detyra* profesionale të shtrimit dhe të veshjes me pllaka në ndërtesa dhe objekte që ndërtohen apo rikonstruktohen, si i punësuar apo i vetpunësuar në kompani apo biznese që veprojnë në fushën e ndërtimit.

Për realizimin me sukses të këtyre detyrave të punës, pllakashtruesi duhet që të zotërojë *njohuri* profesionale që kanë të bëjnë me konceptet dhe procedurat bazë, si dhe *shprehi* profesionale që lidhen me veprimtarinë profesionale të pllakashtruesit.

Suksesi i pllakashtruesit është i lidhur ngushtë dhe me *sjellje* (qëndrime) të tilla si: gjakftohtësia, shkathtësia, kujdesi, përqendrimi, mospërdorimi i pijeve alkoolike, korrektësia, disiplina etj., sjellje që e ndihmojnë atë të plotësojë kërkesat dhe përballojë vështirësitë e punës.

b) Mundësitë e punësimit dhe karriera profesionale e pllakashtruesit

Profesioni i pllakashtruesit është i lidhur ngushtë me procedurat e punës për shtrimin dhe veshjen me pllaka të mjediseve të brendshme dhe të jashtme të ndërtesave të ndryshme. Ai mund të punësohet ose të vetpunësohet në ndërmarrje të ndryshme që ushtrojnë veprimtari në fushën e ndërtimit dhe mirëmbajtjes së ndërtesave.

Me përvojë pune dhe me kualifikime shtesë mund të përparojë profesionalisht në nivelin e pllakashtruesit të kualifikuar. Më pas, nëpërmjet kualifikimit të mëtejshëm në shkollat profesionale apo trajnimin nëpërmjet punës, një pllakashtrues mund të ndërmarrë disa funksione mbikëqyrëse duke ngritur shkallët e karrierës si teknik i mesëm ndërtimi. Ndjekja e shkollës së lartë, çon në diplomimin e specialistëve të këtij profesioni në nivelin e inxhinierit të ndërtimit.

Për të zhvilluar aktivitet privat dhe për vetëpunësim, në fushën e pllakashtrimit duhet regjistrimi për ushtrim aktiviteti si person fizik apo juridik, sipas rastit.

Ky kurs i përgatit kursantët me kompetenca profesionale për të ushtruar veprimtari profesionale të përfshira në njësinë “Shtrues pllakash dhe të tjerë që lidhen me to”, me kod 7122, referuar Listës Kombëtare të Profesioneve

II. Kompetencat që fitojnë kursantët në përfundim të Kursit për Punime pllakashtrimi

Në përfundin të Kursit për “Punime pllakashtrimi”, kursantët do të jenë të aftë të:

- Bëjnë organizimin e vogël të punës gjatë punimeve të pllakashtrimit;
- Studjojnë fletët përkatëse të projektit për punime pllakashtrimi;
- Përzgjedhin materialet, veglat dhe instrumentet e punës së pllakashtruesit;
- Kryejnë llogaritje volumesh dhe materialesh për punime pllakashtrimi;
- Kryejnë llogaritje të thjeshta ekonomike për punimet e kryera;
- Skicojnë mënyra të ndryshme pllakashtrimi.
- Respektojnë parimet e punës në grup dhe bashkëpunojnë për arritjet objektive;
- Riparojnë gabimet eventuale para punimeve të pllakashtrimit;
- Kontrollon dhe shënojnë kuotat të ndryshme për pllakashtrim;
- Formojnë fashot drejtuese dhe nivelojnë dyshemetë;

- Shtrojnë me pllaka dyshemetë në mjedise të brendshme e të jashtme të ndërtesave;
- Veshin me pllaka muret në mjediset e brendshme e të jashtme të ndërtesave;
- Bejnë prerjen e pllakave dhe përpunimin e tyre;
- Pastrojnë fugat dhe i mbushin ato me bojak apo me material tjetër;
- Pastrojnë, mirëmbajnë dhe sistemojnë vendin dhe veglat e punës mbas punimeve të pllakashtrimit.
- Zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit;

III. Kërkesat e pranimit në Kursin për punime pllakashtrimi

Pjesmarrësit në Kursin për punime pllakashtrimi duhet të jenë mbi 16 vjeç, të kenë përfunduar arsimin e detyruar.

IV. Kohëzgjatja e Kursit për punime pllakashtrimi

300 orë mësimore, ku

1 orë mësimore = 45 minuta

V. Modulet e Kursit për punime pllakashtrimi

Nr	Titulli i Modullit	Kodi	Kohëzgjatja	Rezultatet Mesimore
1	Hyrje në profesionin e pllakashtruesit	MK-02-062-18	30 orë mësimore Rekomandohet: 80% Teori 10% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti tregon veçoritë e profesionit të pllakashtruesit. 2. Kursanti liston materialet, veglat dhe instrumentet e punës së pllakashtruesit. 3. Kursanti liston radhën e kryerjes të punimeve të pllakashtrimit 4. Kursanti kryen llogaritje të thjeshta ekonomike për punime pllakashtrimi.
2	Punime përgatitore për pllakashtrim	MK-02-063-18	30 orë mësimore Rekomandohet: 20% Teori 70% Praktike 10% Vlerësime	1. Kursanti skicon mënyra të ndryshme pllakashtrimi. 2. Kursanti shënon kuotat të ndryshme për pllakashtrim. 3. Kursanti bën organizimin e vogël të punës për punime pllakashtrimi.
3	Punime nivelimi dyshemes	MK-02-064-18	50 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti formon fashot drejtuese për nivelimin e dyshemeve. 2. Kursanti nivelon dyshemetë për shtrim pllakash. 3. Kursanti shtron shtresen hidroizoluese, Termoizoluese
4	Punime shtrimi me pllaka	MK-02-065-18	120 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti shtron me pllaka dyshemetë në mjedise të brendshme. 2. Kursanti shtron me pllaka dyshemete në mjedise sanitare 3. Kursanti shtron me pllaka dyshemete në mjedise të jashtme. 4. Kursanti shtron me pllaka sipërfaqet e taracave

5	Punime veshje me pllaka	MK-02-066-18	70 orë Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kursanti vesh me pllaka muret në mjediset e brendshme. 2. Kursanti vesh me pllaka bazamaket e shkallëve. 3. Kursanti vesh me pllaka muret në mjediset të jashtme.
---	-------------------------	---------------------	-----------------------------------------------------------------------	------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

VI. Vlerësimi dhe Çertifikimi

Kursantët vlerësohen nga instruktorët e Kursit për të gjitha Rezultatet Mësimore që përmbajnë të gjitha Modulet e Kursit dhe nëse vlerësohen pozitivisht, futen në Provimin përfundimtar teoriko-praktik.

Nëse vlerësohen pozitivisht edhe në Provimin përfundimtar teoriko-praktik, kursantët fitojnë Çertifikatën përkatëse që njihet nga MFE.

VII. Përshkruesit e Moduleve të Kursit për punime pllakashtrimi:

1. Moduli “Hyrje në profesionin e pllakashtruesit

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	HYRJE NE PROFESIONIN E PLLAKASHTRUESIT	MK-02-062-18
Qëllimi i modulit	Një modul që i njeh kursantët me veçoritë e profesionit të pllakashtruesit, me funksionet, detyrat dhe veprimtaritë e pllakashtruesit, me rradhën e kryerjes së punimeve, me materialet, veglat, instrumentet e punës dhe me mënyrën e llogaritjes së çmimit të punimeve.	
Kohëzgjatja e modulit	30 orë mësimore Rekomandohet: 80% Teori; 10% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar dhe të jenë mbi 16 vjeç	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Kursanti tregon veçoritë e profesionit të pllakashtruesit Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të tregojë funksionet, detyrat, kërkesat dhe kushtet e punës së pllakashtruesit.- të tregojë mundësitë e punësimit të pllakashtruesit.- të tregojë mundësitë e karrierës profesionale të pllakashtruesit- të zbatojë rregullat e komunikimit në mënyrë etike me eprorët, kolegët dhe klientët. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">- Pyetje përgjigje me gojë.- Pyetje përgjigje me shkrim.	
	<p>RM 2 Kursanti liston materialet, veglat dhe instrumentet e punës së pllakashtrimit Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë :</p> <ul style="list-style-type: none">- të dallojë materialet, veglat dhe instrumentet që përdoren për shtrimin dhe veshjen me pllaka- të tregojë përdorimin e materialeve për shtrim pllakash- të tregojë standartet e materialeve për pllakashtrim- të tregojë rregullat e ruajtjes dhe kujdesit për materialet që përdoren për pllakashtrim. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">- Pyetje - përgjigje me gojë.- Pyetje - përgjigje me shkrim.	
	<p>RM 3 Kursanti liston radhën e kryerjes të procesit të punimeve të pllakashtrimit</p>	

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të studjojë fletët përkatëse të projektit;
- të dallojë dhe emertojë ambjentet e ndërtesës;
- të tregojë afatin kohor për çdo proces pune;
- të listojë radhën e kryerjeve të punimeve të pllakashtrimit sipas kushteve teknike;

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje - përgjigje me shkrim.

RM 4 Kursanti kryen llogaritje të thjeshta ekonomike për punime pllakashtrimi.**Kriteret e vlerësimit:**

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të kryejë llogaritje të volumeve të punimeve pllakashtrimi.
- të kryejë llogaritje të materialeve për punime pllakashtrimi
- të llogaritë kostot e punimeve të kryera
- të llogaritë çmimet e punimeve të kryera

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje - përgjigje me shkrim.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset e punës së repartit të ndërtimit. Rekomandohen he vizita e praktika në biznes.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe demonstrime konkrete të çështjeve që trajton.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në klase e në repartin e ndërtimit. Atyre duhet ti jepen detyra që lidhen me kërkesat e modulit. Ata duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike të modulit.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore si Skica, fletë projekti, detaje të ndryshme pllakashtrimi, udhëzuese të kushteve teknike.
 - Mjedise reale të punës në repart ndërtimi.
 - Makina llogaritëse.
 - Komplet i materialeve, veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të punës në ndërtim.
 - Kataloge, rregullore, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

2. Moduli “Punime përgatitore për pllakashtrim“

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	PUNIME PËRGATITORE PËR PLLAKASHTRIM	MK-02-063-18
Qëllimi i modulit	Një modul që i njeh kursantët me skica, me metoda të ndryshme pllakashtrimi, me rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjen e mjedisit, si dhe të bëjë organizimin e vogël të punës për punime pllakashtrimi.	
Kohëzgjatja e modulit	30 orë mësimore Rekomandohet: 20% Teori; 70% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar dhe të jenë mbi 16 vjeç Kursantët duhet të kenë përfunduar modulën “Hyrje në profesionin e pllakashtruesit”	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Kursanti skicon mënyra të ndryshme pllakashtrimi. <i>Kriteret e vlerësimit:</i> Kursanti duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të interpretojë skicat e gatshme me mënyra të ndryshme pllakashtrimi;- të skicojë mënyra të ndryshme pllakashtrimi.- të tregojë rastet ku perdoren (sipas ambjenteve) pllakat të llojeve të ndryshme- të përcaktojë fillimin e punimeve për pllakashtrim- të llogarisë numrin e rrjeshtave në varësi të përmasave të pllakave. <p><i>Instrumentet e vlerësimit:</i></p> <ul style="list-style-type: none">- Pyetje përgjigje me gojë.- Pyetje përgjigje me shkrim.	
	<p>RM2 Kursanti shënon kuotat të ndryshme për pllakashtrim. <i>Kriteret e vlerësimit:</i> Kursanti duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të përzgjedhë instrumentat e duhur për kuotimin- të bëjë matjet e duhura paraprake.- të kontrollojë kuotat reale për çdo proces pllakashtrimi.- të shënojë kuotat e ndryshme për pllakashtrimin.- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik <p><i>Instrumentet e vlerësimit:</i></p> <ul style="list-style-type: none">- Pyetje përgjigje me gojë.- Vëzhgim me listë kontrolli.	
	<p>RM3 Kursanti bën organizimin e vogël të punës për punime pllakashtrimi. <i>Kriteret e vlerësimit:</i> Kursanti duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të vendosë tabelat e sinjalistikës për punime operatore- të formojë grupe pune për punime voluminoze.	

- të kryejë matje të objektit ku do të bëhet pllakashtrimi
- të përcaktojë dhe llogaritë materialet që nevojiten për punimet e pllakashtrimit
- të shpërndajë materialet përkatëse në ambientet e duhura;

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset e punës së pllakashtrimit.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe demonstrime konkrete të çështjeve që trajton.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në klase e në repartin e ndertimit. Atyre duhet ti jepen të skicojnë menyrat e ndryshme të pllakashtrimit, të kontrollojnë dhe shenojnë kuota për punime të pllakashtrimit dhe të bëjnë organizimin e vogël të punës.
- Ata duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi të verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.
- Rekomandohen edhe vizita e praktika në biznes.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore si skica, fletë projekti, detaje të ndryshme të pllakashtrimit, udhëzuesë të kushteve teknike.
 - Mjedise reale të punës në repart ndertimi.
 - Komplet i veglave të vizatimit.
 - Komplet i materialeve, veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të punës në ndertim.
 - Kataloge, rregullore, materiale në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

3. Moduli “Punime nivelimi dyshemesh “

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	PUNIME NIVELIMI DYSHEMESH	MK-02-064-18
Qëllimi i modulit	Një modul që i aftëson kursantet për realizimin e formimit të fashove drejtuese në ambjentet hidrosanitare, të brendshme e të jashtme si dhe për nivelimin e dyshemeve dhe shtrimin e shtresës hidroizoluese dhe termoizoluese.	
Kohëzgjatja e moduli	50 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar dhe të jenë mbi 16 vjeç Kursantët duhet të kenë përfunduar modulin “Hyrje në profesionin e pllakashtruesit” dhe modulin “Punime përgatitore për pllakashtrim”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti formon fashot drejtuese për nivelimin e dyshemeve. <i>Kriteret e vlerësimit:</i> Kursanti duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">- të përzgjedhë mjetet dhe materialet e punës- të kryejë matjet dhe shënimet për formimin e fashove- të formojë fashot drejtuese me pjerrësi nga pileta në ambjentet hidrosanitare.- të formojë fashot drejtuese në ambjente të brendshme të ndërtesës;- të formojë fashot drejtuese në trotuaret e ndërtesës në pozicionin terthor- të formojë fashot drejtuese në ambjentet e jashtme të ndërtesës;- të mirëmbajë veglat e instrumentet dhe të sistemojë materialet mbas punës.- të zbatojë rregullat e sigurisë dhe të mbrojtjes së mjedisit. <i>Instrumentet e vlerësimit:</i> <ul style="list-style-type: none">- Pyetje përgjigje me gojë.- Vëzhgim me listë kontrolli RM2 Kursanti nivelon dyshemetë për shtrim pllakash. <i>Kriteret e vlerësimit:</i> Kursanti duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">- të përzgjedhë mjetet dhe materialet e punës- të kryejë matjet dhe shënimet për nivelimin e dyshemesë- të parapërgatitë mbushësin e dyshemesë- të nivelojë me mbushës dyshemenë në ambjentet hidrosanitare;- të nivelojë me mbushës dyshemenë në ambjentet e brendshme;- të nivelojë me mbushës dyshemene e trotuarit të ndërtesës;- të nivelojë me rërë dyshemenë në ambjentet e jashtme;	

- të mirëmbajë veglat e instrumentet dhe sistemojë materialet mbas punës.
- të zbatojë rregullat e sigurisë dhe të mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM3 Kursanti shtron shtresën hidroizoluese, termoizoluese

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë mjetet dhe materialet e punës
- të kryejë matjet dhe shënimet për shtrimin e shtresës hidroizoluese dhe termoizoluese
- të shtrojë shtresën hidroizoluese në mure dhe dyshemënë e ambjenteve sanitare;
- të shtrojë shtresën hidroizoluese në xokolin dhe trotuarin e ndërtesës;
- të shtrojë shtresën hidroizoluese dhe termoizoluese në tarracën e ndërtesës;
- të mirëmbajë veglat e instrumentet dhe sistemojë materialet mbas punës.
- të zbatojë rregullat e sigurisë dhe të mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset e punës së pllakashtrimit. Rekomandohen edhe vizita e praktika në objekte ku kryhen punime nivelimi.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur me materiale pamore dhe demonstrime konkrete të çështjeve që trajton.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në klasë e në repartin e ndërtimit, për të formuar fashot drejtuese, niveluar dyshemetë dhe shtruar shtresën hidroizoluese dhe termoizoluese në mjedise sanitare, mure, trotuare dhe tarraca.
- Ata duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat praktike që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së aftësive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Skica, fletë projekti, detaje të ndryshme hidroizolimi dhe termoizolimi, udhëzuesë të kushteve teknike.

-
- Mjedise reale të punës në repart ndertimi.
 - Komplete i materialeve, veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të punës për nivelimin.
 - Materiale hidroizoluese dhe termoizoluese
 - Listela të gatshme nivelimi,
 - Mbushës të gatshëm, rëre, çimento,
-

4. Moduli “Punime shtrimi me pllaka”

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	PUNIME SHTRIMI ME PLLAKA	MK-02-065-18
Qëllimi i modulit	Një modul që i aftëson kursantët për të shtruar pllaka të ndryshme në dysHEME të brendshme e të jashtme sipas konfiguracioneve, si dhe të pastrojnë fugat e të hedhin bojakën	
Kohëzgjatja e modulit	120 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar dhe të jenë mbi 16 vjeç Kursantët duhet të kenë përfunduar modulën “Hyrje në profesionin e pllakashtruesit” dhe modulën “Punime përgatitore për pllakashtrim”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti shtron me pllaka dysHEMETË në mjedise të brendshme. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">- të analizojë objektin dhe dokumentacionit teknik;- të kryejë matjet dhe shënime të nevojshme;- të llogaritë materialet që nevojiten;- të përzgjedhë materialet dhe veglat e punës;- të përgatisë kollën e vendosë pllakat referuese;- të shtrojë me pllaka dysHEMENË në ambjente të brendshme;- të presë pllakat sipas përmasave të vendeve bosh;- të vendosë pllakat në vendet bosh- të vendosë plintusat e gatshëm në gjithë perimetrin e ambjentit;- të pastrojë fugat dhe hedhë bojakun e gatshëm duke pastruar sipërfaqen e shtruar;- të mirëmbajë veglat e instrumentet dhe sistemojë materialet mbas punës.- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike të zbatojë rregullat e sigurisë dhe të mbrojtjes së mjedisit Instrumentet e vlerësimit: <ul style="list-style-type: none">- Pyetje përgjigje me gojë.- Vëzhgim me listë kontrolli. RM 2 Kursanti shtron me pllaka dysHEMETE në mjedise sanitare Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë : <ul style="list-style-type: none">- të analizojë objektin dhe dokumentacionit teknik;- të kryejë matjet dhe shënime të nevojshme;- të llogaritë materialet që nevojiten;- të përzgjedhë materialet dhe veglat e punës;- të përgatisë kollën e vendosë pllakat referuese duke i matur me mjete niveluese;- të shtrojë me pllaka dysHEMENË në ambjentet sanitare;	

- të presë pllakat sipas përmasave të vendeve bosh;
- të vendosë pllakat në vendet bosh
- të pastrojë fugat dhe hedhë bojakun e gatshëm duke pastruar sipërfaqen e shtruar;
- të mirëmbajë veglat e instrumentet e sistemojë materialet mbas punës.
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e ruajtjen e mjedisit

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 3 Kursanti shtron me pllaka dyshemetë në mjedise të jashtme.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë

- të analizojë objektin dhe dokumentacionit teknik;
- të kryejë matjet dhe shënime të nevojshme;
- të llogaritë materialet që nevojiten;
- të përzgjedhë materialet dhe veglat e punës;
- të vendosë pllakat referuese duke i matur me mjete niveluese;
- të shtrojë me pllaka dyshemenë në ambientet e jashtme;
- të presë pllakat plotësuese e ti vendosë ato në vendet bosh;
- të ngjeshë me rul sipërfaqen e shtruar;
- të mbushin fugat me rërë të imët dhe fshijnë sipërfaqen e shtruar
- të mirëmbajë veglat e instrumentet, sistemojë materialet mbas pune
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e ruajtjen e mjedisit

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 4 Kursanti shtron me pllaka sipërfaqet e taracave të shfrytëzueshme

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të analizojë objektin dhe dokumentacionit teknik;
- të kryejë matjet dhe shënime të nevojshme;
- të llogaritë materialet që nevojiten;
- të përzgjedhë materialet dhe veglat e punës;
- të vendosë pllakat e gatshme në parapetin e taracës;
- të vendosë pllakat referuese duke i matur me mjete niveluese;
- të shtrojë me pllaka dyshemene në sipërfaqen e taracës;
- të presë pllakat plotësuese e ti vendosë ato në vendet bosh;
- të pastrojë fugat dhe hedhë bojakun e gatshëm duke pastruar sipërfaqen e shtruar;

- të mirëmbajë veglat e instrumentet e sistemojë materialet mbas punës.
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e ruajtjen e mjedisit ;

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset e punës së repartit ndërtimit. Rekomandohen edhe vizita e praktika në biznes
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrime konkrete të çështjeve që trajton.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete ne repartin e ndërtimit.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari praktike për shtrimin e dyshemeve me pllaka ne mjedise të ndryshme
- Ata duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Skica, fletë projekti, detaje te dryshme pllakashtrimi, udhëzuese të kushteve teknike.
 - Mjedise reale të punës në repart ndertimi.
 - Komplet i materialeve, veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të punës pllakashtruesit;
 - Pllaka të llojeve të ndryshme e kryqe;
 - Prerëse pllakash;
 - Pllaka të gatshme parapeti
 - Rëre, bojak, kollë
-

5. Moduli “Punime veshje me pllaka

PERSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	PUNIME VESHJE ME PLLAKA	MK-02-066-18
Qëllimi i modulit	Një modul i aftëson kursantet për të veshur muret, fasadat, shkallët me pllaka të ndryshme, si dhe për pastrimin e fugave e hedhjen e bojakut.	
Kohëzgjatja e modulit	70 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar dhe të jenë mbi 16 vjeç Kursantët duhet të kenë përfunduar modulën “Hyrje në profesionin e pllakashtruesit” dhe modulën “Punime përgatitore për pllakashtrim”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Kursanti vesh me pllaka muret në mjediset e brendshme. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të analizojë objektin dhe dokumentacionit teknik;- të kryejë matjet dhe shënime të nevojshme;- të llogaritë materialet që nevojiten;- të përzgjedhë materialet dhe veglat e punës;- të përgatisë kollën dhe vendosë këndoret e aksesoret e gatshme;- të fiksojë mastar-nivelen dhe vendosë pllakat për rrjeshtin e parë;- të vendosë shiritin zbukurues sipas skicës;- të vesh me pllaka muret dhe vendosë aksesorin përfundimtar sipas skicës;- të presë pllakat me përmasat e vendeve bosh;- të heqë mastarin dhe të vendosë pllakat e prera;- të pastrojë fugat, hedhë bojakun midis tyre e të pastrojë sipërfaqen e veshur;- të mirëmbajnë veglat dhe sistemojnë materialet mbas mbarimit të punës.- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e ruajtjen e mjedisit; <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">- Pyetje përgjigje me gojë.- Vëzhgim me listë kontrolli <p>RM 2 Kursanti vesh me pllaka bazamakët e shkallëve. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë :</p> <ul style="list-style-type: none">- të analizojë objektin dhe dokumentacionit teknik;- të kryejë matjet dhe shënime të nevojshme;- të llogaritë materialet që nevojiten;- të përzgjedhë materialet dhe veglat e punës;- të lagë me ujë sipërfaqen e bazamakëve të shkallës;- të përgatisë kollën dhe vendosë pllakën vertikale veshëse	

- të vendosë mbas ngurtësimit pllakën horizontale duke i kontrolluar me instrumente niveluese
- të vendosë plintat e gatshëm për gjithë gjatësinë e shkallës;
- të hedhë bojakun në sipërfaqen e shkallës duke pastruar atë;
- të mirëmbajë veglat dhe sistemojë materialet mbas mbarimit të punës
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e ruajtjen e mjedisit

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 3 Kursanti vesh me pllaka muret në mjedis të jashtme

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të analizojë objektin dhe dokumentacionit teknik;
- të kryejë matjet dhe shënime të nevojshme;
- të llogaritë materialet që nevojiten;
- të përzgjedhë materialet dhe veglat e punës;
- të vendosë rrjetën mbrojtëse dhe të lidhë skelën me konstruksionin e ndërtesës;
- të kontrollojë sipërfaqen dhe të pastrojë atë ;
- të fiksojë mastar-nivelen dhe pllakat e rrjeshtit të parë;
- të veshin me pllaka muret e fasadave sipas skicës;
- të presë pllakat dhe vendosë në vendet bosh
- të pastrojnë fugat, të mbushin me bojakë dhe pastrojnë sipërfaqen e veshur;
- të mirëmbajnë veglat dhe sistemojnë materialet mbas punës
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e ruajtjen e mjedisit

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset e punës së repartit ndërtimit. Rekomandohen dhe vizita e praktika në objekte ku kryhen veshje me pllaka.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrime konkrete të detyrave praktike të modulit.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete ne repartin e ndërtimit te pllakashtrimit.
- Kursantët duhet te angazhohen në veprimtari praktike për veshjen e bazamakeve të shkallëve dhe veshjen e mureve me pllaka te llojeve te ndryshme ne ambiente te brendshme e te jashtme;
- Kursantet duhet aftësohen edhe që të hedhin bojaken midis fugave në mure te veshura me pllaka.
- Gjate vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së aftësive praktike që parashikohen në këtë

modul.

- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Skica, fletë projekti, detaje të ndryshme veshje me pllaka bazamakësh të gatshme
 - Pllaka të llojeve dhe përmasave të ndryshme, plintusa, bojak, çimento, prerëse pllakash, aksesoret e ndryshëm veshjesh
 - Mjedise reale të punës në repart ndërtimi.
 - Komplet i materialeve, veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të punës në ndërtim.
 - Kataloge, rregullore, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-